



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit i Dëgjimit Publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, mbajtur më 11.7.2023, duke filluar nga ora 14:00. Drejtoria e Arsimit (parafillor, fillor dhe të mesëm) e Komunës së Prishtinës.

Në takim morën pjesë: Osman Bllaca- kryesues, Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave, Mimoza Sylejmani - drejtore e Drejtorisë së Planifikimit, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Lulëzim Vrapca-shefi i arsimit në Drejtorinë e Arsimit, Arton Ajeti -zyrtar i lartë në Drejtorinë e Arsimit, Rrahman Zeqiri -zyrtar nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Besnik Bllaca - zyrtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Të pranishëm ishin edhe: Vezir Bytyqi, Menduha Bajraktari, Bedrije Shala, Zyrafete Kafexholli, Shemsedin Beqiri, Flamur Bujupi, Rifadije Sopi, Ali Berisha, Erisa Abdullahu, Bardh Tahiri, Lum Tahiri, Rinesa Makolli, Stina Halili, Leart Sadiki, Milaim Selmani, Egzon Pajaziti, Avni Osmani, Bujar Kaçuri, Qamile Gashi, Skender Haliti, Arsim Gashi, Shrfki Rusinovci, Filloreta Haxholli, Besnik Mehmeti, Mihrije Spahiu, Lumnie Çitaku, Mimoza Morina, Fahrie Retkoceri, Arbenita Basha, Kadrije Asllani, Besart Ismajli, Betim Sylejmani, Shpresa Shala, Fatmir Zhdrella, Jeta Dida, Xhevrie Osmani, Nexhmedin Sejdiu, Valmir Ilazi, Dardan Brahimi, Albaton Bejta, Donjeta Dragusha, Besart Peshku, Advije Kuqi, Donika Ahmetaj, Besa Luzha, Liridon Maliqi, Albana Musa, Sofije bunjaku, Myrvete Tahiri dhe Fehmi Zeqiri, Enea Kadriu, Verda Muqaj.

Osman Bllaca, kryesues hapi debatin në lidhje me hartimin e buxhetit për vitin 2024, duke thënë se ka kaluar në Kuvend në mbledhjen e fundit, Korniza afatmesme buxhetore, e cila përfshin 3 vitet e ardhshme dhe në kuadër të saj do të nxirret edhe buxheti për vitin 2024. Ai tha se ky debat do të jetë për nevojat e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm.

Valbona Makolli, drejtore: - tha se do t'i dëgjojmë kërkesat e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Ajo tha se deri në shtator duhet të bëhet përgatitja e propozim - buxhetit për vitin 2024 dhe njoftoi se për vitin 2024, me pranimin e qarkores së parë buxhetore, nga Ministria e Financave, Kryeqytetit do t'i takojnë **122.790.872** euro, fondë specifik për arsimin është **26.506.354** euro, ku krahasuar me vitin e kaluar është një ndryshim i vogël prej 2 milionë e 100 mijë euro, krahasuar me kërkesat dhe nevojat që i ka arsimit në kryeqytet. Korniza afatmesme buxhetore është aprovuar në Kuvend. Ajo tha se të gjithë në atë panel janë për t'i dëgjuar kërkesat e qytetarëve dhe varësisht nga niveli i buxhetit që disponojnë, kërkesat do të përfshihen në buxhetin e vitit 2024.

Osman Bllaca, kryesues hapi debatin, i cili do të incizohet dhe është live në youtube.

Ai sqaroi që secili para se të marrë fjalën, të prezantohet me emër dhe mbiemër, eventualisht edhe nga institucioni që vinë, me qëllim që evidentimi i kërkesave të bëhet në mënyrën e saktë.

Shpresa Shala, drejtore e Shkollës "Xhemail Mustafa"- Prishtinë shpalosi kërkesat të cilat janë për shkollën "Xhemail Mustafa", në të cilën janë 1100 nxënës që vijnë në mësim, dhe në fakt janë dy ndërrime, që edhe kabinetet është dashtë të shndërrohen në klasë për shkak të mungesës së hapësirave. Ajo shpjegoi se ka nevojë për një aneks, për të cilin para 3-4 viteve është marrë pëlqimi në Kadastër dhe tek Urbanizmi që ka mundësi të bëhet, për shkak se shkolla "Xhemail Mustafa" nuk ka klasë parafillore, e tash nga viti i kaluar është obligim ligjor që secila shkollë duhet ta ketë një klasë parafillore. Kërkesa tjetër që ajo pati ishte për ndërrimin e dyerve, pasi që, qe 19 vite, dyert nuk janë ndërruar asnjëherë dhe janë në gjendje të keqe, gjithashtu ndërrimi i dyshemeve, ajo tha se është e nevojshme e po ashtu edhe pajisja me kompjuterë nëpër klasë dhe kabinate të teknologjisë, rregullimi i kulmit në sallën e edukatës fizike dhe izolimi i dritareve në kulm, korridor sepse sa herë që ka të reshura atmosferike pikon edhe në sallën e edukatës fizike. Ajo tha se edhe në korridor është rrezik për fëmijë, rregullimi i tualeteve, rregullimi i hapësirës para shkollës për shkak të sigurisë së nxënësve, ndërtimi i një hapësire prapa sallës së edukatës fizike për zhveshtore për nxënës, rregullimi i hapësirës para shkollës, ku është duke u ndërtuar çerdhja, prapa në fakt çerdhja e EU-së, për të krijuar edhe një qasje për fëmijë, sepse shkolla e ka qasjen vetëm përpara, e prapa jo dhe normalisht edhe për qasje të ndihmës së shpejtë ose në rast të emergjencave tonë.

Enea Kadriu, kryetare e Shkollës "Xhavit Ahmeti", tha se shkolla nuk i ka funksionale kamerat e shkollës, gjendja e kabineteve është tmerruese, në të cilat ka myk dhe se nuk i kanë mjetet për të zhvilluar ndonjë aktivitet. Ajo tha se nuk kanë as bufe, as mjete teknologjike, ku disa kompjuterë që janë ajo tha se janë jofunksional. Nxënësja tha se kanë vetëm një projektor, i cili është mundësuar nga fondet e nxënësve, duke cekur edhe mungesa tjera si ato të mjeteve higjienike në tualete, mungesa e dollapëve gjë që ndikon keq tek fëmijët nga ana shëndetësore sepse kanë 6 orë në ditë, nga dy libra, 12 libra, plus edhe fletoret.

Betim Sylejmani, drejtor i Gjimnazit "Sami Frashëri": - tha se është një prej më të vjetërve në Kosovë dhe me mungesë të investimeve qe një kohë të gjatë dhe kërkesa e tij ishte për renovim total, duke filluar nga kulmi e deri në bodrum.

Verda Muqaj, kryetare e Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit: - ceku disa nga problemet më kryesore janë: mungesa e punëtorëve teknikë nëpër shkolla, mungesën e mësuesve mbështetës për personat me aftësi të kufizuara, pjesa e kabineteve dhe ambienteve ku ata mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre qoftë kurrikulare apo ekstrakurrikulare, mungesa e mjeteve teknologjike, mungesa e ndriçimit brenda dhe jashtë shkollës, mungesa e lëndëve higjienike në pastërtinë e shkollave të tyre, mungesa të bankave e po ashtu rregullimin e tualeteve apo infrastrukturës së pjesëve të ndryshme të shkollave të tyre.

Flamur Bujupi, drejtor i Shkollës së mesme të mjekësisë: - fillimisht falënderoi për investimet që janë bërë në periudhën njëvjeçare ose 1 vit e gjysmë që e kanë përmirësuar sado pak gjendjen në atë shkollë. Ai tha se është e nevojshme në mënyrë urgjente për t'u investuar, është një objekt për të cilin Drejtorja e Arsimit, veç e ka planin e detajuar, ku kabinetet do të barteshin në një objekt i cili mund të jetë në lokacionin afër shkollës aty.

Ai tha të ndërtohet një bibliotekë, një sallë leximi. Për objektin ekzistues, ai tha se ka nevojë për meremetim të gjithmbarshëm, së pari me lysterje, me gëlqerosje pasi që ka shumë vite që s'është gëlqerosur fare.

Jeta Dida-Bujari, drejtore e Shkollës së muzikës "Prenk Jakova" në Prishtinë tha se vitin e kaluar është shqyrtuar buxheti i cili është planifikuar për Shkollën e muzikës "Prenk Jakova", mirëpo deri më sot nuk kanë ndonjë përgjigje apo ndonjë fillim konkret të punës së këtij institucioni, duke e ditë se shkolla e muzikës, ende pas 73 vite ekzistence, nuk e ka objektin e saj, duke deklaruar se ata janë duke vepruar në shkollën e mjekësisë, ku është e pamundur të realizohen synimet në atë ambient për shkak të kushteve jo të përshtatshme për punë. Ajo kërkoi një përgjigje se kur do të ndërtohet shkolla dhe a është caktuar lokacioni dhe se a është lokacioni i ndarë për shkollën pronë e kontestueshme.

Mimoza Sylejmani, drejtore: - tha se lokacioni është ndarë vitin e kaluar, ka pas konkurs projektimi për liceun artistik ku aty do të futet edhe shkolla e muzikës dhe janë në fazën e përzgjedhjes së projektit zbatues, kështu që me përfundim do të jetë edhe tenderi i hapur për ndërtim.

Rifadije Sopi, drejtore e çerdhes "Yllkat": - falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm, duke i adresuar disa kërkesa, të cilat janë të nevojshme për institucionin tonë. Ajo tha se e kanë adresuar edhe vitin e kaluar kërkesën për rregullimin e ngrohjes qendrore, të mundësohet me pompë termike, pasi që është sistemi i instaluar, mandej rregullimin e infrastrukturës rrugore në afërsi të kopshtit, e cila lehtëson qasjen e prindërve në kopsht. Tutje tha se kanë adresuar kërkesën për mbulimin e tarracës apo një hapësirë të cilën e kemi adoptuar për zhvillimin e aktiviteteve, rregullimin e daljes emergjente, rregullimin e hapësirës së gjelbëruar. Gjithashtu si kërkesë të fundit, e cila po prek secilin konkurs të pranimit të fëmijëve, ajo ceku përcaktimin e bashkësive lokale dhe zoonimin për kopshtet publike dhe ato publiko-private.

Bedrie Pireva-Shala, drejtore në Shkollën "Ali Kelmendi", Barilevë tha se i falënderohet Drejtorisë së Arsimit, që ka filluar rregullimin e infrastrukturave nëpër fshatra, ndërtimet, rregullimet nëpër shkolla të fshatrave, dhe tha se ajo ka tri kërkesa për shkollën, duke filluar me ndërrimin e dysHEMEVE në shkollë, dritareve që paraqesin problem gjatë dimrit. Kërkesë tjetër e drejtores ishte nevoja për një aneks, pasi që fshati Barilevë posedon gati 6000 banorë dhe nuk ka një çerdhe për fëmijë.

Anila Ajeti, nxënëse e Shkollës "Shkëndija" në Hajvali dhe asambliste në Asamblenë Komunale të Fëmijëve, paraqiti disa kërkesa të shkollës si p.sh. nevoja për një aneks të shkollës, nevoja për kompjuterë në kabinetin e teknologjisë, pasi që janë vetëm 5, kurse aty janë 29-30 nxënës, nevoja për renovim total të sallës së edukatës fizike, sidomos të zhveshtoreve, nevoja për mjete higjienike, nevoja për kompjuterë, llaptop, televizorë smart, projektorë, furnizim të kabinetit të artit dhe muzikës, si dhe bibliotekë të shkollës.

Shemsedin Beqiri, nga Gjumnazi "Eqrem Qabej" tha se një sinjal i mirë është që shtatorin, presim bashkë me nxënësit që ta fillojmë paksa në kushte më të volitshme sepse ka filluar investimi në sanitare dhe në ndërrimin e dyerve, që do të pasojë me gëlqerosjen e shkollës për herë të parë. Por sipas tij nevojat në Gjumnazin "Eqrem Qabej", janë shumë më të mëdha, duke filluar nga nevoja e ndërrimit të dritareve të korridoreve, sepse dimrit kushtet klimatike janë tepër të rënduara për ta, edhe përkundër investimit tepër të madh që bëhet në lëndë djegëse.

Ai tha se duhet bërë ndërrimi i dritareve të korridorit dhe dy balloreve të pjesës veriore dhe jugore, salla e edukatës fizike ka nevojë për t'u intervenuar në tërë ventilimin e saj, nevoja për një kabinet funksional të TIK-ut, dhe se me këto ndryshime do të përmirësohet gjendja, sipas drejtorit.

Besa Luzha, profesoreshë e muzikës në Fakultetin e Arteve, në Universitetin e Prishtinës, si dhe organizatore e shumë ngjarjeve kulturore në Prishtinë. Ajo tha se me shumë kolegë drejtojnë festivale të cilët janë më të rëndësishme të muzikës klasike dhe që kanë një kohëgjatësi shumë të gjatë, pra kemi festivale që sivjet e festojnë 23 vjetorin, si "Kamer Fest", "Re Muzika", "Chopin Piano Fest" që tashmë i ka bërë 13 vite. Tani e kemi edhe festivalin "Ramë Lahaj" i cili fillon tash në korrik, e të gjitha këto ia japin shpirtin Prishtinës. Ajo tha se si fushë e kulturës i kanë kërkesat e tyre sepse në fund të fundit me aktivitete si ato, prezantohet dhe promovohet Kryeqyteti edhe në arenën ndërkombëtare. Dy probleme kryesore sa i përket festivaleve ajo ceku thirrjet për subvencione të cilat po vonohen dhe po zgjasin shumë, dhe kërkoi që së paku ato festivale të cilat janë vërtetë elitare dhe janë dëshmuar, nëse ka mundësi që ato me çfarëdo shume, po themi modeste, për aq sa edhe jepet përmes subvencioneve të futen në buxhetin e rregullt. Ajo tha se kjo do t'ua lehtësonte punën sepse çdo vit do ta dinin përafërsisht sa me llogaritë përkrahje nga Prishtina dhe nuk do të kishin vonesa, paqartësi dhe pasiguri duke pritur rezultatin e thirrjeve. Kërkesa e dytë, natyrisht që është salla që është në buxhet dhe presim me padurim, mirëpo derisa ajo të përfundojë, kemi një propozim që një investim shumë i rëndësishëm do të duhej të bëhej në "Sallën e Kuqe" e cila për momentin ende po vazhdon të shfrytëzohet si e vetmja sallë për aktivitetet e muzikës klasike dhe është në gjendje të mjerueshme dhe besoj që do të ishte mirë që ajo pak a shumë të konsolidohet sepse nuk është investuar në atë sallë aspak, as në dysheme, as në xhama, as në karrige, as në drita. D.m.th pak një rregullim i cili pastaj do të mundësonte që ajo pastaj të përdorej për aktivitete të tjera edhe rinore, edhe të fëmijëve, të nxënësve, klube apo organizata, por edhe për ne derisa të ndërtohet salla e re, kish me qenë pak më dinjitoze. Kërkesa e tretë është të planifikohet në buxhet furnizimi i institucioneve ekzistuese kulturore, që janë në mbikëqyrje të Prishtinës, me piano të kualitetit të mirë, Yamaha, gjysmëkoncertale, diku janë rreth 13.000-14.000 Euro (trembëdhjetë mijë - katërbëdhjetë mijë), 15.000 Euro (pesëmbëdhjetë mijë) në maksimum për çdo institucion p.sh për Teatrin, Oden, Bibliotekën. Sa i përket shkollës së muzikës Mimoza e përmendi Liceun, në kornizën kurrikulare ekziston si pikë e veçantë, si një lloj hapësire e cila precizohet se shkollat e muzikës ose shkollat artistike = në secilën kurrikulë të nivelit, pra niveli 1-5, 6-9 dhe 10-12 precizohet që ekzistojnë shkolla të veçanta artistike dhe këtu duhet ta gjeni një mundësi që shkollat e muzikës, në një far mënyre të dallojnë sepse janë të veçanta, janë ekstra vetëm për talent. Sipas saj nëse Liceu Artistik është gjimnazi, atëherë është në rregull, ajo mund t'i përfshijë shkollën e artit, shkollën e dramës, e të gjitha këto, por në nivelin e mesëm, kurse sipas saj në nivelin e ulët duhet të keni kujdes. Ajo tregoi që Vushtrria e ka bërë shkollën, Gjilani e ka bërë shkollën, Peja e ka bërë shkollën, Mitrovica është duke e ndërtuar shkollën, e nëse ju si Prishtinë doni ta leni Kryeqytetin si të fundit dhe pa shkollë të muzikës, atëherë mbetet në ndërgjegjen tuaj.

Mimoza Sylejmani, drejtore: tha se sapa mori informatë nga drejtorja Arta, që subvencionet veç janë nënshkruar dhe sot bëhet publikimi, e po ashtu tha se Salla e Kuqe do të rinovohet, nga Pallati i Rinisë në bashkëfinancim me Ndërmarrjen Publike Banësore. Për sallën që do të bëhet tek "Gërmia" ajo tha se Kengo Kuma është duke vazhduar projektin zbatues, i cili është një arkitekt shumë i madh botëror dhe kemi pas fatin që ai ka konkurruar për të bërë një sallë dinjitoze siç i ka hije dhe së shpejti pritet përfundimi i projektit zbatues, bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës.

Për një sallë më të vogël, drejtorja tha se janë duke e shikuar në përfundim të detyrës projektuese ku do të hapin konkurs për "Artek", tek "Tullëtorja" ku do të ketë edhe një sallë më të vogël.

Arbenita Basha, drejtore e çerdhes me bazë në komunitet "Shkronjat", të cilat janë themeluar nga 2015 dhe aty për 2-3 vite me radhë 8 çerdhe, të gjitha tani në total që funksionojnë dhe se në atë kohë themeluesit, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës kanë vendos një çmim prej 100 euro që prindërit të paguajnë, që në të funksionojmë me të hyrat që i marrim prej tyre, në bazën e së cilit është lëshuar edhe një vendim nga kryetari i asaj kohe ku subvencionohen prindërit më të hyra më të ulëta. Ajo theksoi se në 2023 ka ngritje të çmimeve nga të gjitha anët, ndërsa atyre u duhet të funksionojnë me ato 100 euro që i marrin njëjtë sikur para 7-8 viteve gjë që po e bënë të pamundur mirëfunksionimin tonë. Tutje tha se kanë drejtuar 3 kërkesa deri tani në komunë dhe nuk kanë marrë përgjigje dhe se janë para kolapsit, stafi po ikën, ka paralajmërimet dhe vendime për greva në disa prej çerdheve dhe se janë duke u munduar ta shtyjmë ditë pas dite përmes disa fondeve emergjente që i kemi, por kjo nuk na zgjatë sepse nuk është që kemi të hyra aq sa me mund me mirëfunksionuar.

Bardh Tahiri, anëtar i Asamblesë komunale të fëmijëve, nga shkolla "Azeme Salihu" në Dabishevc, paraqiti disa ankesa, siç ishte mungesa e bibliotekës në shkollë e cila është e nevojshme edhe për nxënësit dhe ankesa e dytë është për kabinete.

Zyrafete Kafegjoli, drejtore në ardhje e Shkollës "28 Nëntori", shfaqti disa nga prioritetet e saj siç vijnë, renovimi i kulmit të Shkollës "28 Nëntori", i cili pikon vazhdimisht jo vetëm gjatë reshjeve atmosferike, por edhe 2-3 ditë prapa për arsye se grumbullohet diku uji, pastaj renovimi i sallës së edukatës fizike, ngjyrosja e korridorit pasi që klasat janë ngjyrosur vitin e kaluar, ndërsa korridoret dhe hapësirat e tjera përcjellëse të shkollës nuk janë ngjyrosur, ndërrimin e dyerve, renovimi i sanitareve. Po ashtu ajo ceku rrethojën e oborrit të shkollës e cila është mjaft e dëmtuar, por së paku të bëhet ngjyrosja e saj nëse nuk ndërrohet komplet, pastaj kemi vendosjen e reklamës që është në hyrje të shkollës vendosja me emër të Shkollës "28 Nëntori" dhe e fundit është rregullimi i oborrit të shkollës e së paku vendosja e ulëseve në oborr të shkollës, si dhe ndërtimi i një klase verore në kuadër të oborrit të shkollës.

Drejtorja e shkollës "Gjergj Fishta", tha se aktualisht është duke u punuar në pjesën e brendshme të shkollës, por meqë shkolla është ndërtim i vjetër atëherë na mungon investimi në pjesën e jashtme të shkollës, duke thënë se është e domosdoshme që të investohet në fasadë të shkollës dhe të bëhet izolimi për shkak të funksionimit të mirë për ngrohje. Ajo tha se ka nevojë edhe për erëmbrojtës tek streha edhe një, ullugët e shkollës, pjesa gjelbëruese në pjesën ballore të shkollës mungon dhe lë shumë për të dëshiruar, inventarizimi i dy klasave për parashkollorë është më se i domosdoshëm, teknologjia sigurisht që është shumë e dëshirueshme.

Myrvete Tahiri, drejtore e Shkollës "Zenel Hajdini" tha se kjo shkollë është shkollë mjaft e vjetër e, themeluar në vitin 1964 dhe ka nevojë emergjente për renovim gjeneral, duke i lënë anash klasat kabinetike dhe pajisjet digjitale. Ajo tha se dritaret janë të gjitha pothuajse të mbyllura me gozhda, nuk ka themel tamam me armaturë, por është një themel shumë i vjetër dhe nuk ka siguri, pastaj ka qarje horizontale dhe vertikale të shkollës, pas çdo të reshure kulmi mbushet me ujë gjë e cila rasti i fundit është ku janë informuar edhe inspektorët për siguri dhe emergjencë, gjendje të cilën zotëria në panel e

ka parë, ku një pjesë e shkollës është e izoluar me shirit rrezik, por nuk është ndërmarr ende asgjë dhe se uron që deri në shtator të bëhet një ndërhyrje.

Shefki Rusinovci, drejtor i Shkollës “Pavarësia”, falënderoi Komunën e Prishtinës, për nisjen e punimeve në ndërtimin e aneksit duke thënë se ka disa kërkesa si p.sh shkolla ka shumë nevojë për pajisje teknologjike, nevojë për ndërrimin e tabelave, dërrasave të zeza përveç atyre që janë tabela lëvizëse që janë fituar përmes Gizit gjerman. Po ashtu ai theksoi se ka nevojë për mësues mbështetës, për punëtorë teknikë, furnizim me material higjenik dhe materialet e tjera teknike. Gjithashtu ai kërkoi që furnizimi me inventar, banka dhe karrige të jetë më cilësor dhe të jetë adekuat.

Stina Halili, nga asambleja komunale e fëmijëve të Prishtinës dhe përfaqësuese e Shkollës “Meto Bajraktari”, filloi diskutimin me një falënderim që është përzgjedhur shkolla e tyre për renovim total sivjet. Pikë kryesore që ajo u fokusua është mungesa e pastërtisë që është në nivelin më të ulët për shkak të numrit të vogël të punëtorëve teknikë, ku ajo tha se është bërë kërkesa në komunë që të sjellin më shumë punëtorë teknikë. Pika e dytë për të cilën nxënësja foli është siguria e shkollës, sepse nuk është i rrethuar oborri i shkollës. Pikën e tretë ajo e ceku mbështetjen e aktiviteteve ndërkurikulare, ndërsa e katërta është aktivizmi i kabineteve. Ajo tha se gjithashtu vijon mësimet në degën e baletit që 6 vite në Shkollën “Prenk Jakova” dhe mendon që është një prej shkollave primare për t’u marrë parasysh për objekt dhe për kërkesat e tyre, për faktin se artistët kanë qenë gjithmonë ata që e kanë përfaqësuar më së miri vendin tonë në botë dhe mendoj që duhet të kenë një vend dinjitoz për të punuar.

Nexhmedin Sejdiu, nga Shkolla “Pjetër Bogdani” tha se është bërë një investim i jashtëzakonshëm sivjet sepse është rinovuar në brendësi shkolla si tërësi, dyshemeja, tavani, ndriçimi, sanitaria, gjithçka nga brenda dhe nga jashtë që është kompletuar. Ai tha se rruga afër shkollës nuk është ndoshta në domenin e DKA- së, mirëpo në bashkëpunim edhe me drejtoritë e tjera është duke u rinovuar tash, duke u shtruar përsëri është rregulluar edhe kanalizimi. Ai kërkoi që tek ajo rruga “Antigona Fazliu” afër Shkollës “Pjetër Bogdani” me një perimetër 20 m majtas dhe djathtas të mos parkohen veturat brenda ditës ose të bëhet një mundësi vetëm për kalimin e banorëve të lagjes dhe të mos ketë qarkullim tjetër.

Kërkesa tjetër ishte rregullimi i dyerve së bashku me një reklamë me logon e Shkollës “Pjetër Bogdani”. Po ashtu ai kërkoi që fusha e futbollit të shtrohet me një material çfarëdo qoftë ai, sintetik apo diçka tjetër në oborrin e shkollës që të mos jetë ashtu me beton për shkak të rrezikut të fëmijëve që të mos lëndohen gjatë lojës dhe e fundit shkallët emergjente.

Sofije Bunjaku, drejtore e SH.F.M.U “Hasan Prishina”, në Prishtinë, falënderoi DKA-në, për mbështetjen e dhënë kohët e fundit në shkollën, e cila për një periudhë të gjatë është anashkaluar dhe nuk kanë rinovuar asgjë brenda saj, kurse nga viti i kaluar e deri më sot, ajo tha se janë bërë shumë investime në shkollë, sidomos për gëlqerosjen e shkollës, për dyshemenë, për ndërrimin e dyerve të shkollës dhe shumë të tjera, por theksoi se për shkak të numrit të madh të nxënësve 2300, prapë ka kërkesa të shumta, është renovimi i shkollës komplet. Ajo i falënderoi të gjithë me shpresë që kërkesat e saj të jenë të realizueshme.

Besart Ismajli, drejtor i "Shkollës së Gjelbër" pati një falënderim për DKA-në, por edhe për drejtoritë tjera, të cilët kanë investuar në shkollë tash e dy vite mjaft shumë. Ai parashtrori dy kërkesa: e para është se shkolla e ka fasadën e drurit dhe ajo duhet të mirëmbahet ku tash e 12 vite, vetëm një herë është mirëmbajtur dhe sipas specifikacioneve që ka shkolla ajo duhet të mirëmbahet çdo vit. Kërkesa e dytë është që të ndërtohet një bibliotekë ekologjike, ku biblioteka e cila momentalisht gjendet në shkollë të shndërrohet në dy klasë dhe ekologjike, për shkak të specifikacioneve që ka shkolla, pra të jetë bibliotekë e drurit e cila nuk ka kosto shumë të madhe, por të jetë edhe një kënd me libra ekologjike.

Albana Musa, sekretare në Gjimnazin "Xhevdet Doda" tha se kërkesat e tyre janë kryesisht elementare, e para është rregullimi i kulmit, në katin e tretë kur kushtet atmosferike janë jo të mira, është e pamundur të mbahet mësimi, ku rrezikohet jeta e stafit dhe nxënësve kryesisht. Si kërkesë të dytë e tha rregullimin e dymëve nëpër klasë, si dhe mungesën e stafit teknik.

Erisa Abdullahu, anëtare e asamblesë komunale të fëmijëve dhe përfaqësuese e shkollës "Nëna Terezë", shprehu kërkesën për përfundimin dhe realizimin e objektit shkollor në këtë vit, meqenëse ka mbetur në plan që nga viti 2020. Ankesa tjetër e saj ishte mungesa e pajisjeve teknike, si fotokopje, kompjuterë, lloptopë, dhe pika e fundit tha se është mungesa e higjienës nëpër tualete dhe klasë.

Lulëzim Vrapca, shefi i sektorit të arsimit përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit. Ai tha se e di shumë mirë që kërkesat për investime janë të vazhdueshme dhe të gjithë ata që nuk janë të kyçur shumë në proceset edukativo – arsimore, po ta shihnin këtë prej televizionit do të dukej sikur realisht si një film i metrazhit të shkurtër që nuk është punuar aspak, por ai theksoi se veçanërisht në shkolla e dimë se si dhe cilat janë atë procedura ato burokraci realisht procedurale që duhet t'i ndjekim, që duhet t'i procedojmë. Ai tregoi që për kaq pak kohë, janë dy shkolla që janë investuar tërësisht dhe që ka ndryshuar gama e investimeve nëpër shkolla. Z. Vrapca shpjegoi se kanë 1.6 milion euro, që kanë me u investuar tërësisht në 4 shkolla, "Hoxhë Kadri Prishtina", "Naim Frashëri", "Meto Bajraktari" dhe "Gjergj Fishta", pra janë renovim i tërësishtëm. Për kontratën për kulme, ai tha se është lidhur pardje, dhe realisht kompanitë janë në vëzhgim e sipër nëpër terren që t'i marrin gjitha paramasat e duhura për të intervenuar në to. Sa i përket kontratës për pastrim, ai tha se e di që është vonuar shumë, për shkak të ankesave që kanë qenë në organin shqyrtues të prokurimit publik. Pika e radhës ishte, furnizimi me inventarë, dollapë nëpër klasë prej 1 deri në 5, që ai tha se është projekt i vazhdueshëm i Drejtorisë së Arsimit, nga viti i kaluar edhe këtë vit kjo do të jetë në procedim e sipër ku ai tha se përsëri do të furnizohen shkolla të caktuara me këtë pjesë. Për ndërtimin e bibliotekave, në disa shkolla që kanë një numër të vogël të nxënësve, ai tha se ata duhet ta shikojnë mundësinë se si ta shndërrojmë një klasë në bibliotekë. Për fasadat e drurit e përmendi edhe Shkollën e Gjelbër, një shkollë ekologjike, shumë e veçantë ashtu sikurse është edhe "Qamil Batalli", për to realisht do të shikojmë një mundësi sa i përket intervenimit në këto dyja me një partneritet.

Vanesa Gashi, anëtare e Asamblesë komunale për fëmijë dhe përfaqësuese e shkollës "Isa Boletini":-tha se ka mungesë të kabinetit të teknologjisë, ju duhen edhe lloptopë, përfundimi i sallës së sportit, dhe së fundmi rregullimi i tualeteve.

Lulzim Fushtica, drejtor: - falënderoi të gjithë dhe tregoi se një prej prioriteteve kryesore në fushëveprimin që ka drejtorja është patjetër siguria në shkolla, siguria në komunitet dhe siguria në hapësira publike. Ai tha se kanë filluar një inspektim të përgjithshëm të të gjitha shkollave, sa i përket aspektit të sigurisë, aspektit të infrastrukturës, kamerave, rrethojave të gjitha. Sa i përket shkollës “Zenel Hajdini”, ai tha se kanë bërë një vlerësim emergjent, dhe e kanë drejtuar në Drejtorinë e Arsimit. Ai tutje tha se kontrata për kulm është vetëm e nënshkruar dhe do të vazhdohet të bëhet renovimi, mirëpo sipas mendimit të drejtorisë sonë, kjo shkollë kërkon renovim të përgjithshëm. Ai theksoi se një pjesë e madhe e shkollave kanë kamera, por do t’i shikojmë se cilat shkolla kanë probleme, cilave nuk ju funksionojnë. Rrethojat janë problematike, qasja fizike, qasja e personave të tretë në ambientet e shkollës dhe gjitha këto çështje janë adresuar dhe do të adresohen, e gjithashtu edhe problemet që kërkojnë ndoshta edhe investime më të mëdha, siç janë, shkallët emergjente, një pjesë e madhe e institucioneve nuk kanë, janë një mori e çështjeve që jemi duke i adresuar.

Betim Sylejmani:- tha se nëse do të ishte e mundur që të parashihet në buxhet, sigurimi fizik i shkollave nga Komuna e Prishtinës pasi që shkollat e mesme kanë sigurime fizike private të cilat i paguajnë prindërit në forma vetanake, por të parashihet sidomos të shkollat e qytetit, diku 30 shkolla, të bëhet një kalkulim i buxhetit që vitin tjetër të paguhet nga komuna.

Osman Bllaca, kryesuesi:- mbylli takimin duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrjen dhe tha se shpreson që kërkesat e tyre të inkorporohen në buxhetin e vitit 2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

14:11 - 15:20

Dëgjim publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024;

11.07.2023

Ora 14:00

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Gjinia	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	VGZIR	BUTIRI				
2	Menduh	Bajraktari				
3	Beakije	Shala				
4	Zymajete	Kotxhollari				
5	Ghemurdin	Begini				
6	FLANUR	Pašur				
7	Rifadri	Loni				
8	Ali	Beuisha				
9	Enisa	Abdullahu				
10	Bardh	Takiri				

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do*

të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Lum	Tahirri				
12	Rinesa	Makolli				
13	Stima	Halili				
14	Leart	Sophdy				
15	Milaim	Shamir				
16	Edon	PAJAZITI				
17	Armi	OSMANI				
18	Bujar	KACUR I				
19	Basmile	Gashi				
20	SKENDER	HALILI				
21	Arsim	Gashi				
22	Refik	REZINDUQI				
23	Hilorida	Harholli				
24	Besnik	Mehmeti				
25	Nihalje	Spahiu				
26	LUMNITË	ÇITAKU				
27	Mimoza	Morina-Veseli				
28	FAHRIJE	ZETROCERI				

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do*

të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	Arbenita Basha	Basha				
30	Kadrije Arslani	Arslani				
31	Besart	Ismajli				
32	Betim Syljani	Syljani				
33	Syrena Shala					
34	FATMIR	ZHORELLA				
35	Jeta	Diola Buyari				
36	Agnesa	Albano				
37	Khemi	Osmani				
38	Merhmedin	Sejdiu				
39	Valmir Hazi					
40	Dardan Basha	Brahimi				
41	Albaton	Berta				
42	Danjeton	Dragusha				
43	Besart	Lesht				
44	Ilir Dvizi	Kuci				
45	Danika	Almetaj				
46	Thesa	Arifaj				
		<p>P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!</p> <p>*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*</p>				

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
47	LIRIDON	MALIQI				
48	ALBANA	MUSA				
49	SOFIJE	BUINJAKU				
50	Myrvete	Talini				
51	Felimi	Feg'ni				
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!